



VENDIM

Nr. 117, Datë 8.10.2013

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TE PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT
TE ADMINISTRATORIT, TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË CEZ
SHPËRNDARJE**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 Janar 2013 “Për heqjen e licensave të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, për aktivitetin e shpërndarjes së energjise elektrike, miratuar me vendimin nr. 08, date 25.01.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008, të ndryshuar”, Vendimit nr. 5, datë 21.01.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për vendosjen e shoqërisë cez shpërndarje sh.a, në administrim të perkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë cez shpërndarje sh.a, në zbatim të vendimit të bordit të komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 janar 2013, “Për heqjen e licensave për aktivitetin e shpërndarjes të energjise elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjise elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje SH.A.”, neni 4 i Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2013, mbasi shqyrtoi kërkesën e administratorit aktual të perkoshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje për lirimin nga detyra dhe relacionin e Drejtorive teknike të ERE,

Vendosi :

1. Te pranoje doreheqjen e paraqitur nga ana e administratorit aktual të shoqërisë, Z. Sahit Dollapi, i cili do të vijojë ushtrimin e detyrës deri në momentin e përzgjedhjes së administratorit të ri të shoqërisë CEZ Shpërndarje nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE.

2. Fillimin e procedurave te përzgjedhjes se administratorit të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit të përgatisë gjithë procedurat në lidhje me zbatimin e këtij Vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI